	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 1 nga 3

Kodi: 079

Shkathtësitë për zhvillim personal

Tipi i Programit: **Plotësues**

Historiku i Programit

Programi “Shkathtësitë për zhvillim personal- PEACOCK” ka dal si rezultat i punës disavjeçare që është bërë në kuadër të projekteve FACE-PEACOCK e që për qëllim ka mbështetja e bashkëjetesës paqësore të të gjitha grupeve etnike në Kosovë, përmes prezantimit të programit mësimor për zhvillimin personal. Projektii është përkrahur nga Fakulteti i Mësuesisë në Cyrih PHZH. Nga vitin 2020 është punuar në krijimn dhe përkthimin e udhëzuesve për Zhvillim Personal-FACE për klasat 1-5 si dhe Zhvillimi personal-PEACOCK për klasa 5-9, në këtë proces është përfshirë edhe Fakulteti i Edukimit i Prishtinës. Udhëzuesit u dedikohen mësimdhënësive të cilët ua mësojnë nxënësve të tyre shkathtësitë për jetë dhe ato ndërlihdhëse. Udhëzuesit fokusohet në mënyrat si të mësohen shkathtësitë ndërlihdhëse që janë të nevojshme për zhvillimin e nxënësve të shëndetshëm në aspekt fizik dhe mental dhe e përkrah zhvillimin e identitetit të tyre personal.


Qëllimet e programit:

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit duhet të jenë gjendje:

- Të kuptojnë çfarë janë shkathtësitë për zhvillim personal
- Të kuptojnë shkathtësitë për zhvillim personal janë pjesë përbërëse e shkollës dhe jetës
- Të përvetësojnë teknika dhe metoda për të prezantuar shkathtësitë personale sipas udhëzuesve përkatëse
- Të jenë të gatshëm të shfrytëzojnë materialet online
- Të jenë të gatshëm për të shpërndarë dijet dhe informacionet edhe tek palët e treta

Përmbajtja:

Edukimi për zhvillim personal dhe shkathtësi për jetë është i inkorporuar në të gjitha lëndët dhe gjithmonë është i ndërlihdhur me përmbajtjen mësimore që është relevante për individin në gjendjen e tij momentale të zhvillimit. Përmbajtja dhe detyrat në këtë program të zhvillimit personal janë të dizajnuara dhe synojnë grup moshë dhe klasa të ndryshme nga klasa parafillore deri tek klasa e 9-të . Përgjatë kurrikulës së shkollimit të obligueshëm, mësimi i shkathtësive për jetë bëhet gjithnjë e më kompleks, duke përcjellë tema të ngjashme çdo vit e duke u fokusuar në të njëjtat shkathtësi gjatë gjithë kohës në shkollë.

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 2 nga 3

Në këtë program për zhvillim personal, shkathtësitë për jetë mësohen në një sekuencë prej pesë modulesh të cilat i përfshijnë konceptet kryesore. Ato janë

Moduli 1 “Arti i vetë-njohjes dhe njohjes së të tjerëve” që e thekson vetë-njohjen dhe vetëbesimin, hulumtimin dhe vetë-vlerësimin e burimeve personale, familjen si vlerë: përgjegjësit, rolet gjinore, stereotipat, komunikimin me vendosmëri, pa konflikt dhe pa dhunë, vullnetarizmin, etj

Moduli 2 “Sigurimi i cilësisë së jetës”, me theks në integritet, menaxhim efikas të burimeve, përgjegjësi për zhvillim të qëndrueshëm, menaxhim i mirë i vetes, etj.

Moduli 3 “Stilet e jetës së shëndetshme” që i udhëzon nxënësit në çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin fizik dhe emocional, ushqimin e shëndetshëm, që i kundërvihet shprehive: drogës, alkoolit, duhanpirjes, ndikimit gjinor, etj.

Moduli 4 “Dizajnimi i karrierve personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse” që thekson të kuptuarit e profesioneve që nga perspektiva e tregut, planifikimit të karrierës dhe vendimmarrjes në lidhje me karrierën, opsionin e ndërmarrësisë si karrierë, etj.

Moduli 5 “Siguria personale” që i pajis nxënësit me qëndrim të orientuar kah sjellja për të siguruar sigurinë e tyre personale dhe të të tjerëve.

Grupi i synuar


Ky program i dedikohet, mësimdhënësve, studentëve, pedagogëve, udhëheqësve të shkollave dhe profesorëve të fakultetit

Forma e organizimit /Kohëzgjatja

Ky program trajnimi organizohet në formën on-line dhe si i tillë do të ketë një efekt të fortë motivues për të gjithë përdoruesit. Me qëllim të zhvillimit të shkathësive për zhvillim personal, pjesëmarrësit sidomos mësimdhënësit dhe studentët në Kosovë, duhet ta shohin këtë formë mësimi si një inovacion që mund të mbështesë dhe inkurajojë zhvillimin e tyre të vazhdueshëm profesional. Pjesëmarrësi regjistrohet për vijimin e programit të trajnimit përmes platformës <https://kec-elearning.org/peacock>

Pjesëmarrësi e ndjek tempon individuale të të nxënit duke naviguar në programin e trajnimit. Pjesë të përmbajtjes së programit të trajnimit mbështeten me prezantime me PPT dhe vido-incizime si dhe Udhëzuesit elektronike që mundësojnë lexim më të thelluar për përmbajtje ecaktuara.

Kursi mund të ndiqet nga pjesëmarrësi njëherësh (pa ndërprerje) ose në sesione të disahershme (me ndalesa), duke iu përshtatur kohës në dispozicion të pjesëmarrësit. Vlerësohet se kursi mund të përmbushet për 20 orë efektive.

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 3 nga 3

Programi i trajnimit mund të modifikohet dhe të ipet për grupe nga 20-25 veta duke i përdorur të gjitha prezantimet dhe udhëzuesit.

Vlerësimi/Certifikimi

Në fund të këtij programi të trajnimit pjesëmarrësit do të certifikohen duke u kredituar me gjithsejt 20 orë trajnimi.

Kriteret për certifikim janë:

- Përshkimi i gjithë përmbajtjes së programit të trajnimit (të gjitha temave të të 5 moduleve)
- Përmbushja e kërkesave të cilat dalin nga detyrat e programit të trajnimit
- Suksesi së paku 80% në reflektimet përgjatë kursit;

Materialet e trajnimit

1. Udhëzuesit për Shkathësi për jetë <https://ipe-textbooks.phzh.ch/de/albanien/>
2. Modulet online <https://kec-elearning.org/peacock>